

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AGRO RISINA 2023” shpk**

Sot me date 10.11.2023 (dymije e njezet e tre), formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“AGRO RISINA 2023” shpk** me ortak te vetem themelues:

**Zj. Stolie SHURDHI**, e bija e Dalipit, e datlindjes 01.10.1972, lindur ne Mendrak dhe banuese ne Lagjen “2 Dhjetori”, Rruga “Mestan Ujaniku”, nr.23, Hyrja nr. 2, apartamenti nr.5, Kodi postar 5401, njesia administrative Çorovode, Bashkia Skrapar, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, e martuar, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar ne baze te Nr. ID 035078359 dhe Nr. Personal H26001097H.

Ortaku i vetem themelues, me vullnetin e tij te lire dhe te plete, harton kete Akt-Themelimi te Shoqerise **“AGRO RISINA 2023” shpk**, mbeshtetur ne ligjin 9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar me ligjin 9723 date 03.05.2007, “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, Kodin Doganor, Fiskal e tatimor, si me poshte:

**KREU I**

**KRIJIMI**

**Neni 1**

Shoqeria **“AGRO RISINA 2023” shpk** eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ( me poshte e quajtur “Shoqeria”).

**PERSONALITETI JURIDIK**

**Neni 2**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.



Shoqeria “**AGRO RISINA 2023**” shpk, eshte nje shoqeri, qe themelohet nga ortaku i vetem qe perballon humjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

## SELIA

### Neni 3

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**AGRO RISINA 2023**” shpk eshte ne adresen Lagja “2 Dhjetori”, Rruga “Mestan Ujaniku”, nr.23, Hyrja nr. 2, apartamenti nr.5, Kodi postar 5401, njesia administrative Çorovode, Bashkia Skrapar.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyre perfaqesie, filiale, dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise vetem me vendim te Ortakut te Shoqerise.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

### Neni 4

Objekti i veprimitarise te shoqerise “**AGRO RISINA 2023**” shpk eshte:

Tregtim materialesh te çdo lloji qe nuk kerkojne leje apo autorizime te veçanta dhe qe lejohen nga legjislacioni shqiptare. Konceptim dhe menaxhim te aktiviteteve te kultivimit te kulturave bujqesore dhe blegtoriale, e te tjera. Organizim te trainimeve dhe programeve edukuese ne fushen e bujqesise dhe blegtorisë, si dhe hartim projektesh dhe dokumentacionesh per thithje fondesh dhe aplikime te ndryshme. Zhvillimin dhe kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore dhe tregtimin e tyre me shumice dhe pakice, Brenda dhe jashte Republikes Shqiperise. Kultivimin masiv te frutave te pyllit, vreshtave, pemave frutore, drureve frutore me qellim tregtimin e produkteve dhe nenprodukteve te tyre me shumice dhe pakice. Prodhimin e farerave, fidaneve dhe tregtimin e tyre. Ngritjen e industrise perpunuese te prodhimeve bujqesore dhe blegtoriale, te zonave rurale. Mbarshtrim blete, akrepash dhe perpunim nenproduktesh. Ngritjen dhe zhvillimin e agroturizmit, fermave dhe rezorteve te zonave rurale. Eksperimentimin e teknologjive te reja ne kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore. Import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha prodhimeve bujqesore e blegtoriale ne gjendjen e tyre natyrale, te fresketa, te gjalla apo te perpunuara (industrializuara apo ne menyre artizanale), blerjes se farnave, fidaneve, medikamenteve te ndryshme per mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit. Import-eksport dhe tregtim me shumice dhe pakice te makinerive per prodhim bujqesor dhe blegtorial, ndertimi i

sistemeve te ujites, ngritja e linjave dhe makinerive te perpunimit te produkteve agroushqimore, etj. Nxiten dhe organizimin e te gjitha aktiviteve sociale dhe kulturore, qe kane te bejne me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve te fermereve, buqesore dhe blegtorale. Konsulence ne fushen e ekonomise, buqesise, blegtorise dhe ushqimit duke perfshire planet e menaxhimit te cilesise, mjedisit, turizmit dhe agroturizmit. Perhapja e kulturave per ngritjen e fermave AgroTurizem. Kultivimi i te gjitha produkteve buqesore bio dhe te tjera, tregimi i tyre me shumice dhe pakice, Brenda dhe jashte vendit. Blerja e shitja e pronave, ndertesave te drejtperdrejta ose me ane te kontrates te ndertesave civile dhe industrial ristrukturimin dhe restaurimin e ndertesave, vepra te urbanizimit. Marrja me qera dhe leasing i prones se luajtshme dhe te paluajtshme, blerjen dhe menaxhimin e fermave, blerja e tokes te çdo lloji, marrjen me qira te tyre. Shoqeria mund te marre perfaqesime dhe te perm bushin keshilla teknike ne fushat e kompetencave te saj. Ndertimin, ristrukturimi, shtrimin dhe rrrenimin per vete dhe per palet e treta, te kontraktoreve te trete, blerjen, shitjen, menaxhimin dhenien me qira te : komplekse turistike, sportive, banimi, hotele, pensione, bare dhe i çdo iniciative lidhur aktivitete te tjera turistike hotelerie ne per gjithesi.

## KOHEZGJATJA

### Neni 5

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKB).

## KREU II

### KAPITALI I SHOQERISE

#### Kapitali Themeltar

### Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise tregtare **“AGRO RISINA 2023” shpk** eshte 100.000 leke, i ndare ne 1 kuota shoqerie me vlere 100 lek sejciла, ku ortaku i vetem **Stolie Shurdhi** zoteron nga 100.000 leke ose 100% te kuotave te kapitalit. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre(pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejtë). Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e



cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga çasti i cenimit.

Kapitali themeltar mund te shtohet me vendim te ortakeve te saj duke respektuar kerkesat e ligjit.

## **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

### **Neni 7**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimive te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Biznesit (QKB) per rregjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".

## **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

### **Neni 8**

Kuotat e kapitalit, te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe trjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributi ne kapitalin e shoqerise,
- b) Shitblerjes,
- c) Trashegimise,
- d) Dhurimit,
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj,

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim. Statuti mund te kushtezoje kalimin e kuotave, vecanerisht duke percaktuar miratimin e shoqerise ose te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se

çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimi i ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshi ketu formalitetet e Biznesit ose te publikimit te kontrates apo kalimit te titullit.

### KREU III

#### ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI

##### Neni 9

###### Organi vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja Ortakut te vetem eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Ndryshimet e statutit,
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve,
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike,
- f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
- i) Pjestimin e kuotave te shoqerise dhe anullimin e tyre,
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
- m) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucionin financier kreditor.
- n) Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## KUORUMI

### Neni 10

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur ne kete nen, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## MARRJA E VENDIMEVE

### Neni 11

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit te regjistruar, shprendarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres per çeshtje te tjera si:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) emerimin e shkarkimin e administratoreve,
- c) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
- d) percaktimin e shperblimeve,
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- g) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.



Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 12**

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator Zj. Stolie Shurdhi, shtetase shqiptare, atesia Dalip, e datlindjes 01.10.1972, lindur ne Mendrak dhe banuese ne Lagjen “2 Dhjetori”, Rruga “Mestan Ujaniku”, nr.23, Hyrja nr. 2, apartamenti nr.5, Kodi postar 5401, njesia administrative Çorovode, Bashkia Skrapar, e martuar, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, identifikuar ne baze te Nr. ID 035078359 dhe Nr. Personal H26001097H, sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjeçare me te drejte riporteritje.

Asambleja e ortakut te vetem, mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe. Statuti, apo merreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Perveç kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkesa te çdonjerit prej ortakeve. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per rregjistrim prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Emerimi i administratorit prodhon efekte pas rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

## **KOMPETENCAT**

### **Neni 13**

Administrator ka te drejte e detyrohet te :

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtrise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme.
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare,
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise,
- d) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisese veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim,



- e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per trethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- f) kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit (QKB),
- g) Raportoje perpara asamblese se ortakut/ortakeve te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- h) Kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligje dhe ne statut.

Administratori ka te dreje te kryeje te gjitha veprimet e administritimit te zakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizik e juridic, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave. Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteteve Doganore, etj, ne te gjitha trethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

#### **PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

##### **Neni 14**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij,
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria,
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja,

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jetë ne te njejtin konflikt interes i ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### **PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

##### **Neni 15**

Administratori eshte perjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç se eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori:

1. Detyrohet:
  - a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemannje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis,
  - b) Te ushtroje kompetencat qe i nijhen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita,
  - c) Te vleresoje me perjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim,
  - d) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise,
  - e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te rsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij nenit, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e provesper te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese ne kundershtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, kryen veprimet e meposhtme:
  - a) U kthen ortakeve kontributet,



- b) U paguan ortakeve interesa apo dividend,
- c) U shperndan aktivet shoqerise,
- d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet,
- e) Jep kredi.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi (kallzim) penale kunder administratorit. Ortaket kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plotë te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshireedhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendimi asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **VITI FINANCIAR**

### **Neni 16**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me i Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

## **BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

### **NENI 17**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakeve vendos rrreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, si edhe parashikohet nga ligji.

## **EKSPERTET**

### **Neni 18**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkaur nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodic e ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## FITIMI

### Neni 19

Te ardhurat neto qe mbeten pas vecimit te fondevi ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiscal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi ortakeve.

## KREU IV

### PRISHJA, BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE

#### PRISHJA E SHOQERISE

### Neni 20

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar

1. Prishet :
  - a) Kur mbaron kehezgjatja, per te cilen eshte themeluar,
  - b) Me perfundimin e procedurave te falimentimit ao ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit,
  - c) Ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfuksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare,
  - d) Ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuar nga neni 3/1 i ketij ligji,
  - e) Ne raste te tjera, te parashikuara me ligj,
  - f) Per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.
2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "e", "f", dhe "g", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87 te ligjit.
3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara ne shkronjat "a", "c", "e", dhe "g" te pikes 1 te ketij neni,



çdo person i interesuar mund ne çdo kohe, ti drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistanca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara nga shkronjat "a", "c", "e", "f", dhe "g", te pikes 1, te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te forms se prere, te permendur ne pikën 3, te ketij neni, shkaku i prishjes eshte korriguar, nese eshte e mundshme te korigohet, dhe ky korrigim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuar.
5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentit, kur ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likujduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendoz rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentitmit.
6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "d", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve ne nenit 3/1 te ketij ligji.

#### **LIKUIDUESI**

##### **Neni 21**

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorit/eve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata vepojne veçmas neri tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne nerin prej tyre te kryeje veprime ten je kategorie te posaçme. Kufizimet e tagrave te likuiduesveu kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikqyrjes se ortakut/eve dhe administratorit/eve.

#### **TE DREJTAT E DETYRIMET E LIKUIDUESIT**

##### **Neni 22**

1. Detyra e likuidueve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, sipas 194 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komadite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me perggjjesi te kufizuar miratohen nga sambleja e pergjithshme.

#### **PERFUNDIMI I LIKUIDIMIT**

##### **Neni 23**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetur, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çrregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”, i ndryshuar.

#### **BASHKIMI**

##### **Neni 24**

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqerive, që quhen shoqerite e perthithuara, te nje shoqerie tjeter ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, që bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim I nje shoqerie te re.

#### **NDARJA**

##### **Neni 25**

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume



shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.

2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe per gjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ka si pasoje:
  - a) Kalimin e shoqerise pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta.
  - b) Berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake ten je ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes.
  - c) Vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çrregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit, sipas seksionit V te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

#### **SHNDERRIMI**

##### **Neni 26**

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderimit te saj ne shoqeri aksionare. Shnderimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

#### **BAZA LIGJORE**

##### **Neni 27**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerise tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **MOSMARREVESHJET**

##### **Neni 28**



Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

#### **DISPOZITA PERFUNDIMTARE**


#### **Neni 29**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaku/Ortaket e shoqerise tregtare **“AGRO RISINA 2023” shpk**, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

#### **ORTAKU THEMELUES**

#### **I SHOQERISE “AGRO RISINA 2023” shpk**

**Stolie SHURDHI**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Stolie Shurdhi". Below the signature is a stylized, handwritten mark or initial.